



KRETARIA
SHKIA KAVAJË



REPUBLICA E SHQIPERISE
BASHKIA KAVAJE
SEKTORI I NDIHMES EKONOMIKE
RELACION

Në mbështetje të Ligjit 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjesvendore", i ndryshuar; Ligjit nr.84/2022, datë 24.11.2022; Ligjit 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"; Vendimit të Këshillit te Ministrave nr.597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" i ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.68, dt.23.12.2024 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Kavajë për vitin 2025", Vendimit te Keshillit Bashkiak nr.2 dt.24.01.2025 "Për miratimin e kriterieve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri ne 6% nga fonda i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si dhe për ato që do të trajtohen me fonde buxhetit vendor, ju relatojmë si me poshtë:

1. Për muajin **Janar 2025** trajtohen me ndihmë ekonomike deri ne 6%, 7 familje, me fond 37.185 lekë. Lista bashkëlidhur. Ky fond është nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale. Në këtë listë futen familjet aplikuese që i plotësojnë kriteret të miratuar në Këshillin Bashkiak në Janar të cdo viti, dmth familjet që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme në sistem, familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme, familje me anëtarë që janë në mos hë pensioni dhe nuk trajtohen me pension sepse nuk kanë vjetërsi pune, familje që nuk kanë kushte jetese dhe janë në varfëri ekstreme. Në tabelën bashkëlidhur janë të ndara në njësi: Kavaja, Syneji, Golemi, Luzi i Vogel, dhe Helmësi në numër dhe fond për cdo njësi dhe totali i perbashkët. Familjet që përfitojnë përzgjidhen nga sistemi në Drejtorinë Rajonale Tiranë, duke theksuar se familjet që kanë mbi 5 vite që marrin ndihmë ekonomike nga sistemi i NE përjashtohen nga sistemi, pasi ndihma ekonomike nuk mund të merret përgjithmonë. Këto familje orjentohen drejt zyrës së punes për tu përfshirë në programet e punësimit sipas ligjeve të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

2. Nga buxheti i Bashkisë Kavajë për muajin **Janar 2025** trajtohen me ndihmë ekonomike 8 familje, me fond 307.855 lekë. Lista bashkëlidhur. Ky fond është nga buxheti i Bashkisë Kavajë llogaria "Transfertë në buxhetet familjare". Në këtë listë futen familjet aplikuese që i plotësojnë kriteret e miratuar në Këshillin Bashkiak në Janar të cdo viti, d.m.th familjet që nuk kanë marrë pikët në sistem, familjet që nuk kanë asnjë pjestar të familjes në punë dhe nuk kanë ardhura, familje që kanë të ardhura të pamjaftueshme, familje me anëtarë që janë në mos hë pensioni dhe nuk trajtohen me pension sepse nuk kanë vjetërsi pune, familje që nuk kanë kushte jetese, familje që kanë në përbërje persona të sëmurë dhe nuk janë të aftë për punë. Këto edhe bazë të verifikimeve në familje që bëjnë çdo muaj administratorët shoqëror të ndih-


ekonomike.

Në tabelën bashkëlidhur janë të ndara në njësi Kavaja, Syneji, Luzi i Vogel, dhe Helmësi, në numër dhe fond për cdo njësi dhe totali i perbashkët.

Këto familje miratohen nga Këshilli Bashkiak.

Kjo ndihme jepet per ti ndihmuar sadopak keto familje dhe për të zbutur disi nivelin e varfërisë.

PËRGJ.NDIHMËS EKONOMIKE
RUDINA KADIU



SEKRETARI
BASHKIKA